



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

ANALIZA E AVOKATIT TË POPULLIT PËR AKTVENDIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE NË RASTIN NR. KO155/14

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. DKGJK-001-2014, datë 31 gusht 2014

PËRMBAJTJA

I. Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese pretendon se Dekreti i Presidentes është në linjë me marrëveshjen ndërkombëtare, por ***nuk jep asnjë argument*** për këtë pretendim, dhe ***nuk i përgjigjet asnjë argumenti*** të Avokatit të Popullit mbi këtë pikë.

II. Në të vetmin vend në gjithë Aktvendimin ku Gjykata citon fjalët e marrëveshjes ndërkombëtare, ***fjalia e cituar është cunuar, duke hequr pikërisht atë pjesë*** që tregon se tre gjyqtarët ndërkombëtarë duhet të marrin propozim nga Kuvendi.

III. Aktvendimi i Gjykatës pretendon se propozimi nga Kuvendi është i nevojshëm vetëm në rastin e “*gjyqtarëve të rinj kosovarë*” dhe jo të “*gjyqtarëve të tanishëm ndërkombëtarë*”, por ***nuk jep asnjë arsytim*** për një pretendim të tillë, dhe ***nuk citon asnjë nen të Kushtetutës*** që bën dallimin midis “*gjyqtarëve të rinj kosovarë*” dhe “*gjyqtarëve të tanishëm ndërkombëtarë*”.

IV. Aktvendimi i Gjykatës pretendon se argumentet e Avokatit të Popullit mbeten jashtë jurisdiksionit *ratione materiae* të Gjykatës sipas standardit të Rastit KO95/13, por ***nuk citon asnjë argument*** të Avokatit të Popullit që bie në kundërshtim me standardin e përcaktuar në atë rast.

V. Aktvendimi i Gjykatës pretendon se “[m]andati i gjyqtarëve ndërkombëtarë . . . është i përcaktuar me kontratë të ofruar nga aktorë ndërkombëtarë,” por ***nuk jep asnjë argument*** dhe ***nuk citon asnjë instrument ligjor ose kushtetues*** që mbështet një pretendim të tillë.

I. Aktvendimi i Gjykatës pretendon se Dekreti i Presidentes është në linjë me marrëveshjen ndërkombëtare, por nuk jep asnjë argument për këtë pretendim, dhe nuk i përgjigjet asnjë argumenti të Avokatit të Popullit mbi këtë pikë

Pjesa më e madhe e Aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese përqendrohet tek pikat që edhe Avokati i Popullit nuk i ka vënë në dyshim në kërkesën e tij. Për shembull, Gjykata jep një shpjegim të gjatë për të treguar se në të vërtetë u lidh një marrëveshje ndërkombëtare midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, dhe se kjo marrëveshje në të vërtetë u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës (shih Aktvendimin, par. 38-40). Këto pika nuk i ka kontestuar fare Avokati i Popullit në kërkesën e tij (shih Kërkesën e Avokatit të Popullit, f. 11 “[K]jo kërkesë nuk konteston aspak kushtetutshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian”). Në vend të kësaj, argumenti kryesor i Avokatit të Popullit ka qenë që as dispozitat relevante kushtetuese, as përmbajtja e marrëveshjes ndërkombëtare në fjalë, nuk i lejojnë Presidentes që të vazhdojë mandatin e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pas përfundimit të këtij mandati, pa u propozuar këta gjyqtarë nga ana e Kuvendit (shih Kërkesën e Avokatit të Popullit, §II, me titullin “Vazhdimi i mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pa propozimin e Kuvendit, nuk justifikohet nga përmbajtja e marrëveshjes ndërkombëtare e vitit 2014 midis Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian” f. 10-22). Edhe Gjykata Kushtetuese nuk pretendon se këtë propozim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës e kanë marrë tre gjyqtarët ndërkombëtarë.

Në vend që të merret drejtëpërsëdrejti me këtë argument kryesor të Avokatit të Popullit, Aktvendimi pretendon **pa asnjë arsytim** që “[n]ë të vërtetë, Dekreti, i nxjerrë nga Presidentja, është në linjë me obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të inkorporuara në Marrëveshjen Ndërkombëtare” (Aktvendimi, par. 41). Në këtë paragraf, dhe në paragrafet në vijim, Gjykata nuk paraqet **asnjë argument** për një pretendim të tillë, dhe nuk u jep **asnjë përgjigje** argumenteve të Avokatit të Popullit mbi këtë pikë.

Pastaj, Gjykata vazhdon të pretendojë se “Dekreti i Presidentes së Kosovës shërben si një akt implementues i atyre dispozitave të Marrëveshjes Ndërkombëtare që nuk janë të vetëkërkueshme,” (Aktvendimi, par. 41). Mirëpo, përsëri Gjykata Kushtetuese nuk paraqet **asnjë arsytim** për këtë pretendim, madje nuk jep **asnjë citim specifik** që tregon se cilat janë “at[o] dispozita” të cilave u referohet.

Siç u theksua më sipër, **një ndër pyetjet kryesore të këtij rasti** ka qenë nëse Dekreti i Presidentes “[n]ë të vërtetë . . . është në linjë me . . . Marrëveshjen Ndërkombëtare.” Fakti që Gjykata ka vendosur të trajtojë një ndër pyetjet kryesore të një rasti me vetëm një paragraf të shkurtër, **pa arsytim, pa citim, dhe pa iu përgjigjur argumenteve të parashtruesit** mbi pikërisht këtë pyetje, tregon një varfëri shqetësuese të shtjellimit juridik, si dhe një shpërfillje të standardeve më elementare të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm.

II. Në të vetmin vend në gjithë Aktvendimin ku Gjykata citon fjalët e marrëveshjes ndërkombëtare, *fjalja e cituar është cunguar, duke hequr pikërisht atë pjesë që tregon se tre gjyqtarët ndërkombëtarë duhet të marrin propozimin nga Kuvendi*

Megjithëse asnjë dispozitë specifike e marrëveshjes ndërkombëtare nuk citohet në paragrafin 41, as në paragrafet në vijim, ka vetëm një paragraf në gjithë Aktvendimin ku Gjykata Kushtetuese citon **disa nga fjalët** e marrëveshjes. Mirëpo, edhe ky **citim i vetëm, i cunguar** nuk mund të mbështesë pretendimin e Gjykatës që “[n]ë të vërtetë, Dekreti, i nxjerrë nga Presidentja, është në linjë me . . . Marrëveshjen Ndërkombëtare.”

Ky citim gjendet jo në pjesën e argumentimit të Aktvendimit, por në përmbledhjen e fakteve, ku shkëputet një gjysmë-fjali nga letra e Presidentes Jahjaga. Në pjesën e cituar, Gjykata thotë se Presidentja konfirmon “*emërimin e [...] gjyqtarëve ndërkombëtarë që shërbejnë në Gjykatën Kushtetuese dhe të emëruar nga PCN-ja [...]*”, (Aktvendimi, par. 15, duke cituar par. 8 të Letrës së Presidentes Jahjaga). Megjithatë, edhe ky citim i vetëm është i mangët, sepse Gjykata **hoqi një ndër pjesët më të rëndësishme të fjalisë**. Në këtë pjesë, Presidentja Jahjaga shkruan se konfirmimi i tre gjyqtarëve ndërkombëtarë është i vlefshëm “*që nga data e kësaj letre me [anglisht: “upon”] përfundimin e procedurës së lartpërmendur*” (theks i shtuar).¹

Cila është “*procedura e lartpërmendur*”? Ka vetëm një procedurë të lartpërmendur në letër që ka të bëjë me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, dhe kjo është procedura e emërimit të gjyqtarëve nga EULEX-i “*sipas neneve 65, . . . 114, respektivisht 84 të Kushtetutës,*” e cila përmendet në paragrafin e shtatë të letrës. Siç është argumentuar me hollësi në Kërkesën e Avokatit të Popullit, kjo procedurë kërkon që gjyqtarët të propozohen nga Kuvendi, sepse të tri dispozitat kushtetuese të cituara në atë pjesë të letrës, nenet 65, 114 dhe 84, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të prerë se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet ta marrin një propozim të tillë (shih Kërkesën e Avokatit të Popullit, §II.B.2, f. 16-22). Gjykata Kushtetuese nuk i ofron **asnjë përgjigje** këtij argumenti.

Prandaj, edhe në **fjalinë e vetme të cituar** nga Gjykata, marrëveshja në fjalë thekson që konfirmimi i emërimit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë kushtëzohet me përfundimin e një procedure që përcakton se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të **propozohen nga Kuvendi**. Së këndejmi, as citimi i vetëm i marrëveshjes ndërkombëtare i dhënë nga Gjykata Kushtetuese nuk mund të japë **asnjë bazë** për pretendimin e Gjykatës që “[n]ë të vërtetë . . . Dekreti, i nxjerrë nga Presidentja, është në linjë me . . . Marrëveshjen Ndërkombëtare.” Ky pretendim kyç mbetet **plotësisht i paarsyetuar** në gjithë Aktvendimin e Gjykatës. Për këtë pretendim, Gjykata nuk sjell **asnjë dëshmi apo fakt** të vetëm.

¹ Siç përcaktohet shprehimisht në krye të letrës së Baroneshës Ashton në gjuhën shqipe, ky verzion i letrës është “Përkthim jozyrtar” i verzionit zyrtar të gjuhës angleze. Verzioni në gjuhën shqipe përkthen gabimisht fjalën “upon” me “*deri në*”. Përkthimi i saktë i fjalës “upon” në gjuhën shqipe, në kontekstin kohor, është “*me*”. Fjalja e plotë në verzionin zyrtar është: “*I confirm the appointments of EULEX judges, appointed pursuant to our previous exchange of letters, and prosecutors serving under EULEX KOSOVO as well as the international judges serving in the Constitutional Court and appointed by the International Civilian Representative, as of the date of this letter upon completion of the aforementioned procedure*” (theks i shtuar).

III. Aktvendimi i Gjykatës pretendon se propozimi nga Kuvendi është i nëvojshëm vetëm në rastin e “gjqtarëve të rinj kosovarë” dhe jo për “gjqtarëve të tanishëm ndërkombëtarë”, por nuk jep asnjë arsytim për një pretendim të tillë, dhe nuk citon asnjë nen të Kushtetutës që bën dallimin midis “gjqtarëve të rinj kosovarë” dhe “gjqtarëve të tanishëm ndërkombëtarë”

Edhe pretendimet e Aktvendimit lidhur me Kushtetutën, njësoj si ato lidhur me marrëveshjen ndërkombëtare, jepen **pa asnjë arsytim**. Në paragrafin 43 të Aktvendimit, Gjykata Kushtetuese

“thekson se neni 84 (19) [Kompetencat e Kuvendit], i Kushtetutës, i cili thotë, si në vijim: ‘Presidenti i Republikës së Kosovës: [...] emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit [...]’, ka të bëjë me emërimin e gjyqtarëve të rinj kosovarë në Gjykatë, ndërsa Dekreti ka të bëjë me vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve të tanishëm ndërkombëtarë. Kësisoj, neni 84 (19) i Kushtetutës nuk është i aplikueshëm në rastin e tanishëm.”

Përsëri, edhe në këtë paragraf, një pretendim kyç i Aktvendimit jepet pa dhënë **asnjë argument**. Siç evidentohet nga vetë citimi i dhënë nga Gjykata, **neni 84 (19) është i aplikueshëm** për “gjqtarët për Gjykatën Kushtetuese,” pa bërë ndonjë dallim midis “gjqtarëve të rinj kosovarë” dhe “gjqtarëve të tanishëm ndërkombëtarë”. Gjykata Kushtetuese **nuk citon asnjë dispozitë** në gjithë Kushtetutën, që mbështet një dallim të tillë. Avokati i Popullit thekson se, edhe Gjykata Kushtetuese është e obliguar t’i përmbahet tekstit normativ të legjitimuar në mënyrë demokratike – Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Arsyeja për mungesën e citimit është e thjeshtë: dallimi midis gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe gjyqtarëve kosovarë **nuk ekziston** më në Kushtetutë, dhe prandaj nuk mund të shërbejë si bazë për vazhdimin e mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë pas përfundimit të këtij mandati. Gjatë pavarësisë së mbikëqyrur, është e vërtetë që “*për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë ishte ndjekur një procedurë tjetër dhe ishin aplikuar kërkesa të tjera nga ato për emërimin e gjyqtarëve kosovarë,*” (Aktvendimi, par. 44, theks i shtuar). Por ajo që Gjykata e lë pa përmendur në Aktvendim është se, kjo “*procedurë tjetër*” që “*ishte ndjekur*” për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë, **është fshirë në tërësi** nga Kushtetuta me mbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur (shih Amendamentin 13 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Neni 152 fshihet*”, duke përfshirë paragrafin 4 të atij neni, i cili përcaktonte se “[t]re (3) gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil”), dhe Kërkesën e Avokatit të Popullit, f. 3 (me amendamentimin e Kushtetutës, “*dispozitat kalimtare u fshinë, duke përfshirë kompetencat e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.*”).

Siç është theksuar qartë në Kërkesën e Avokatit të Popullit (shih f. 2), tre gjyqtarët ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në vitin 2009 për një mandat tre-vjeçar, sipas procedurës së vjetër të përcaktuar në nenin 152 të Kushtetutës para

amendamentimit. Me përfundimin e këtij mandati në vitin 2012, sipas së njëjtës procedurë të emërimit, mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë u vazhdua deri më 31 gusht 2014. Por, me përfundimin e këtij mandati të fundit, **nuk ekziston më asnjë procedurë e posaçme**, qoftë në Kushtetutë, qoftë edhe në marrëveshjen ndërkombëtare, përmes së cilës tre gjyqtarëve ndërkombëtarë mund t'u vazhdohet përsëri mandati, pa marrë propozim nga Kuvendi. Me fshirjen e nenit 152 nga Kushtetuta, nenet 65, 84 dhe 114 janë të vetmet dispozita kushtetuese që mund të shërbejnë si bazë për një vazhdim të tillë të mandatit, dhe të tri këto dispozita përcaktojnë në mënyrë të prerë që, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të marrin propozim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Këto pika, siç u theksua më sipër, janë argumentuar në mënyrë të hollësishme në Kërkesën e Avokatit të Popullit ((shih f. 13, “(1) Kushtetuta nuk i lejon Presidentes të konfirmojë vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, pa marrë propozim nga Kuvendi dhe, (2) asgjë në përmbajtjen e marrëveshjes ndërkombëtare nuk e ndryshon këtë”). Këtij argumentimi nuk i jepet **asnjë përgjigje** nga Aktvendimi i Gjykatës.

Megjithatë, edhe po të mos ishin të mjaftueshme argumentet e lartpërmendura, kredibiliteti i Aktvendimit të Gjykatës mbi këtë pikë bie edhe më shumë përpara një fakti të fundit: **Edhe dispozitat e fshira bëjnë të qartë** se, pas përfundimit të mandatit të përcaktuar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar për tre gjyqtarët ndërkombëtarë, ata “do të ndërrohen *sikur është e parashikuar me Kushtetutë*” (Kushtetuta, neni 152, pika 5; theks i shtuar). Procedura “e parashikuar me Kushtetutë”, siç është argumentuar vazhdimisht në Kërkesën e Avokatit të Popullit, si dhe në këtë analizë, përfshin **propozimin** e çdo gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese nga ana e Kuvendit. Përballë këtij fakti, pretendimi i Gjykatës Kushtetuese që propozimi nga Kuvendi është i nevojshëm vetëm për gjyqtarët “kosovarë” dhe jo për gjyqtarët “ndërkombëtarë” **nuk ka asnjë mbështetje, jo vetëm në Kushtetutën pas amendamentimit, por edhe në Kushtetutën para amendamentimit**. Në verzionin e Kushtetutës pas amendamentimit, dallimi midis dy llojeve të gjyqtarëve nuk ekziston, kurse në verzionin e Kushtetutës para amendamentimit, dallimi ekziston, por gjithashtu përcaktohet në mënyrë të prerë se, pas përfundimit të mandatit të specifikuar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, gjyqtarët ndërkombëtarë “do të ndërrohen *sikur është e parashikuar me Kushtetutë*”. Prandaj, të dyja verzionet e Kushtetutës, ai para amendamentimit dhe ai pas amendamentimit, janë dy rrugë që na çojnë në të njëjtin destinacion: **procedura e parashikuar nga Kushtetuta për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke përfshirë marrjen e propozimit nga ana e Kuvendit, duhet respektuar**.

IV. Aktvendimi i Gjykatës pretendon se argumentet e Avokatit të Popullit mbeten jashtë jurisdiksionit *ratione materiae* të Gjykatës sipas standardit të Rastit KO95/13, por nuk citon asnjë argument të Avokatit të Popullit që bie në kundërshtim me standardin e përcaktuar në atë rast

Në paragrafin 45 të Aktvendimit, “Gjykata vëren se argumentet e parashtruesit të kërkesës **kryesisht ndërlidhen me përmbajtjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare**” (theks i shtuar), dhe sugjeron që këto argumente, si rrjedhojë, mbeten jashtë jurisdiksionit *ratione materiae* të Gjykatës sipas standardit të Rastit KO95/13, i cili përcakton se “Gjykata nuk ka juridiksion *ratione materiae* për të trajtuar çështjen nëse marrëveshjet ndërkombëtare janë në përputhje me Kushtetutën” (Aktvendimi, par. 46). Mirëpo, Gjykata nuk citon **asnjë argument** në gjithë kërkesën e Avokatit të Popullit, që ka vënë në dyshim kushtetutshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare. Përsëri, arsyeja për mungesën e citimit është e thjeshtë: Avokati i Popullit nuk ka dhënë asnjë argument të tillë në gjithë kërkesën e tij.

Dekreti i Presidentes pretendon të bazohet në marrëveshjen ndërkombëtare, si dhe në një shkresë të EULEX-it, e cila pretendon gjithashtu të bazohet tek delegimi i kompetencës së emërimit në po të njëjtën marrëveshje (shih Dekretin nr. DKGJK-001-2014 të Presidentes së Republikës së Kosovës dhe Kërkesën e Avokatit të Popullit, f. 7). Prandaj, nuk është ndonjë gjë e habitshme që argumentet e paraqitura nga Avokati i Popullit “**ndërlidhen kryesisht me përmbajtjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare**”. Por, siç dëshmohet në vetë Aktvendimin e Gjykatës tek paragrafi 46, i cituar më sipër, standardi relevant i jurisdiksionit *ratione materiae* në këtë rast **nuk është** pyetja, “A **ndërlidhen** argumentet e parashtruesit me një marrëveshje ndërkombëtare?” Standardi relevant është pyetja “A kanë të bëjnë argumentet e parashtruesit me **kushtetutshmërinë** e marrëveshjes ndërkombëtare?” Prandaj, fakti që argumentet e Avokatit të Popullit “**ndërlidhen kryesisht**” me një marrëveshje ndërkombëtare nuk paraqet asnjë problem lidhur me jurisdiksionin e Gjykatës, përderisa këto argumente nuk e vënë aspak në dyshim **kushtetutshmërinë** e kësaj marrëveshjeje. Edhe një herë, Gjykata Kushtetuese nuk citon **asnjë argument** në gjithë kërkesën e Avokatit të Popullit që ka të bëjë me kushtetutshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare, sepse argument i tillë **nuk ekziston**.

V. Aktvendimi i Gjykatës pretendon se “[m]andati i gjyqtarëve ndërkombëtarë . . . është i përcaktuar me kontratë të ofruar nga aktorë ndërkombëtarë,” por nuk jep asnjë argument dhe nuk citon asnjë instrument ligjor ose kushtetues që mbështet një pretendim të tillë

Në paragrafin 44 të Aktvendimit, Gjykata pretendon se: “Mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë dallon gjithashtu dhe është i përcaktuar me **kontratë të ofruar nga aktorë ndërkombëtarë**” (theks i shtuar). Këtu kemi të bëjmë përsëri me një pretendim që jepet **pa arsytim** dhe **pa citim** të ndonjë dispozite ligjore ose kushtetuese. Siç pohohet me të drejtë nga vetë Gjykata në paragrafet 14 dhe 42 të Aktvendimit, tre gjyqtarët ndërkombëtarë janë emëruar vetëm “*deri më 31 gusht 2014*”. Pra, mandati nuk është thjeshtë “*i përcaktuar me kontratë të ofruar nga aktorë ndërkombëtarë,*” por ka pasur një përfundim specifik.

Krejt në fund, duhet nxjerrë në pah që burimi i kësaj teorie të pasaktë është një komentari mbi Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ai komentari pretendon se, ndryshe nga “*vendimet për emërim, përkatësisht riemërim të të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve dhe anëtarëve tjerët ndërkombëtar nëpër trupat kosovare të privatizimit, pronës dhe të ngjashme, [të cilët] kanë mandat deri në fund të gushtit 2014,*” në rastin e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese “*është përdorur një formë tjetër [e emërimit] e cila nuk e lidhë punën e tyre për një mandat specifik por për pasjen e fondeve për financim të tyre në dispozicion për kohën pas fundit të gushtit 2014.*” Enver Hasani, “Kapitulli XVI: Dispozitat Kalimtare”, në Enver Hasani dhe Ivan Cukalovic, *Komentari: Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, f. 685, fn. 934 (theks i shtuar). Me fjalë të tjera, sipas këtij komentari, në vend që të caktohet një mandat specifik që përfundon në fund të gushtit 2014, siç është bërë në rastin e zyrtarëve të tjerë, riemërimi i tre gjyqtarëve ndërkombëtarë thjeshtë “*është bërë për kohën sa të ketë mjete financiare të mbështetjes së tyre,*” *id.*, f. 698.

Kjo teori është e **pasaktë**. Siç u pa më sipër, edhe Aktvendimi i Gjykatës nuk e mohon faktin që tre gjyqtarët ndërkombëtarë në të vërtetë kanë pasur një mandat specifik, i cili përfundoi më 31 gusht 2014. E njëjta gjë është e dukshme në vetë tekstin e vendimeve për riemërimin e tyre (shih, p.sh. Vendimin nr. 2012/19 të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, neni 1, par. 1: “*Robert Carolan riemërohet gjyqtar ndërkombëtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës deri më 31 gusht 2014*” (theks i shtuar)). Në të vetmin paragraf në gjithë vendimin ku përmendet çështja e financimit, parashikohet se “*Komisioni për të Emëruarit ka kompetenca që të përfundojë këtë emërim . . . në rast se nuk ka më financim në dispozicion*” (*id.*, neni 1, par. 2, theks i shtuar), por nuk parashikohet në asnjë mënyrë kompetenca që të vazhdojë emërimin pas datës së përfundimit të përcaktuar shprehimisht në po të njëjtin nen, i cili ishte 31 gusht 2014.

Prandaj, ideja e Aktvendimit që “[m]andati i gjyqtarëve ndërkombëtarë . . . është i përcaktuar me kontratë të ofruar nga aktorë ndërkombëtarë” është e **pabazuar**. Mandati i tyre ka qenë i përcaktuar - dhe i përcaktuar qartë - nga vendimet e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar të botuara në Gazetën Zyrtare, dhe jo nga kontrata jopublike “të ofruar[a] nga aktorë

nderkombëtarë”. Ky mandat përfundoi më 31 gusht 2014. Pas kësaj date, tre gjyqtarëve ndërkombëtarë do të mund t’u vazhdohej përsëri mandati vetëm brenda dispozitave të Kushtetutës së sotme, jo në baze të dispozitave kalimtare tashmë të fshira, as në bazë të kontratave të reja për financim nga “aktorë ndërkombëtarë”. Siç është theksuar në Kërkesën e Avokatit të Popullit, dhe siç është ritheksuar disa herë në këtë analizë, këto dispozita të Kushtetutës së sotme përcaktojnë, në mënyrë të qartë dhe të prerë, se çdo gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, pa përjashtim, duhet të **propozohet** nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Për këtë arsye, Dekreti i Presidentes, i cili e vazhdoi mandatin e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë, pas përfundimit të këtij mandati dhe pa u kryer kjo procedurë e propozimit, ka qenë akt kundërkushtetues, dhe duhej shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese.

Kopje: Z. Enver Hasani, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës